

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                           |
|---------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Mbi 50 mijë euro për ndihmësit e deputetëve/ REL: Sa do t'i kushtojnë buxhetit të Kosovës asistentët e deputetëve?                                                                                                                        |
| ADRESA  | <a href="https://piranjat.al/kosova/mbi-50-mije-euro-per-ndihmesit-e-deputeteve-rel-sa-do-ti-kush-tojne-buxhet-i104157">https://piranjat.al/kosova/mbi-50-mije-euro-per-ndihmesit-e-deputeteve-rel-sa-do-ti-kush-tojne-buxhet-i104157</a> |
| BURIMI  | piranjat.al                                                                                                                                                                                                                               |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                                    |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 15 shtator 2026, 06:33:41 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 15 shtator 2026, 06:16:30 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 7b68c9717cfa2995b627ae1c4f1686e3629bd38b81c508d4a6446bc91a9dd8af |
| TEKSTI     | 072da6288c7cc8e668f8594648bb17720806e1dcabc8a12cff8f2f93e685a154 |
| PAMJA      | cb38d25bcb1e8ce18343fe0d3120af81fd131456f7970d197beac5c2e676315  |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | b0b75a11c26a1620f9b3e8a40b542cefa472d29ffefe3938fa82e191b394ac75                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 144dcc84d15b7d80530ccf1620af6bb24eccd27028b717aa2669aa241970dde3                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b0b75a11c26a1620f9b3e8a40b542cefa472d29ffefe3938fa82e191b394ac75>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash:

[persona](#)

[Gjermanisë...](#)

[masën e  
sigurisë ndaj](#)

[ndaj  
kryetarit  
të](#)

[dne  
qeverisë  
së tiil](#)

[njëpasnjëshme.  
Protestuesi...](#)

[r-tonte  
tek ish-  
kazernat](#)

[konkurs  
ndërkombëtar  
për  
transformimin](#)

[parlamentet  
me alternativ...](#)

KOSOVA

## Mbi 50 mijë euro për ndihmësit e deputetëve/ REL: Sa do t'i kushtojnë buxhetit të Kosovës asistentët e deputetëve?

Piranjat Përditësimi i fundit 15 Shtator 2026, 08:16



Megjithëse Kuvendi i Kosovës për më shumë se një muaj nuk zhvilloi punë parlamentare, gati gjysma e deputetëve angazhuan ndihmës personale që në ditët e para pas betimit. Në këtë periudhë, Kuvendi ishte i bllokuar në procesin e konstituimit dhe nuk mbajti seanca pune për shqyrtimin e ligjeve apo çështjeve të tjera të agjendës parlamentare. Njohës të punës së Kuvendit e vlerësojnë si "të papërgjegjshëm dhe joetik" angazhimin e asistentëve në këtë periudhë.

Kuvendi u shpall i konstituuar vetëm më 13 shtator – madje, me një nënkryetar mangët, pasi Partia Demokratike e Kosovës (PDK) tërhoqi kandidaten e saj dhe nuk mori pjesë në vazhdimin e seancës inauguruese.

Më vonë, të njëjtën ditë, 62 deputetë zgjedhën Qeverinë e re të Kosovës, të katërtën e udhëhequr nga Albin Kurti i Lëvizjes Vetëvendosje (LVV).

Nga gjithsej 120 deputetë sa ka Kuvendi, 52 prej tyre, deri më 11 shtator, kishin ushtruar të drejtën për të angazhuar asistentë. Madje, sipas të dhënave të siguruar nga organi legjislativ, 12 deputetë u bënë me ndihmës më 7 gusht, një ditë pas betimit të tyre.

Pjesa tjetër angazhuan asistentë ditëve të tjera të gushtit (32 deputetë) dhe gjatë shtatorit (8 ligjvënës).

### Sa do t'i kushtojnë buxhetit të Kosovës asistentët e deputetëve?

Rroga e një zyrtari personal, sipas Kuvendit, është 972.4 euro bruto, pa përfshirë shtesën për përvojën e punës.

Kësisoj, për një muaj, 52 asistentët do t'i kushtojnë buxhetit mbi 50 mijë e 500 euro.

Rregullorja e punës së Kuvendit përcakton se stafi politik i ofron mbështetje profesionale dhe teknike deputetit, në ushtrim të funksionit të tij.

Kurse, me aktin e veçantë të miratuar nga Kryesia e Kuvendit, janë të rregulluar aspekte të tjera të angazhimit të kësaj kategorie të zyrtarëve politikë.

Sipas rregullores për Shtesa mbi Pagën Bazë për Deputetët dhe asaj për Klasifikimin e Pagës për Stafin Mbështetës Politik të Kuvendit, kontrata e zyrtarëve të deputetëve është e lidhur me mandatin e punëdhënësit politik.

Një ditë pas betimit më 6 gusht, asistentë angazhuan 12 deputetë: katër nga PDK-ja, shtatë nga Aleanca dhe një nga LVV-ja. Angazhimi i stafit mbështetës u intensifikua gjatë muajit gusht, kur u angazhuan edhe 32 asistentë, derisa në dhjetë ditët e para të shtatorit u morën në punë tetë asistentë të tjerë.

### "Sjellje e papërgjegjshme dhe joetike e deputetëve"

Sipas Naim Jakajt nga Instituti i Kosovës për Drejtësi dhe Eugen Cakollit nga Instituti Demokratik i Kosovës, fakti se angazhimi i asistentëve është i rregulluar në aspektin legjislativ nuk e justifikon veprimin nga deputetët – duke pasur parasysh se pa konstituimin e Kuvendit, ata nuk kishin obligime në të cilat do të mund t'i u ndihmonin asistentët.

Jakaj thotë për Radion Evropa e Lirë se deputetët që kanë angazhuar asistentë para konstituimit të Kuvendit, duhet ta arsyetojnë nevojën reale për angazhimin e tyre, si dhe punën konkrete që është kryer.

Pavarësisht se deputetët dhanë betimin, Kuvendi nuk ishte i konstituuar, kujton Jakaj, duke shtuar se ligjvënësia nuk kanë mundur ta ushtrojnë në plotësi funksionin e tyre parlamentar, ndërsa Kuvendi nuk ka zhvilluar aktivitetin e rregullt parlamentar që do ta arsyetonte në të njëjtën masë nevojën për staf mbështetës.

Jakaj thotë se problematike janë veçanërisht angazhimet e deputetëve menjëherë pas betimit, në një kohë kur nuk kishte punë parlamentare, komisione funksionale dhe seanca të rregullta.

“Fakti që një veprim lejohet nga Rregullorja nuk e përfundon diskutimin. Legaliteti është vetëm standardi minimal. Nga deputetët kërkohet edhe përgjegjshmëri etike dhe profesionale në përdorimin e parasë publike”, shprehet ai për REL-in.

Cakolli, ndërkaq, pohon se edhe vetë rregullorja e punës së Kuvendit angazhimin e asistentëve e lidh me ushtrimin e funksionit të deputetëve dhe, kështu, është e diskutueshme nëse ata mund të angazhonin staf mbështetës pa u konstituuar Kuvendi.

“Deputetët nuk mund të ushtrojnë funksionin për sa kohë që nuk ka Kuvend të konstituuar, sepse i njëjti mund të fillojë punën, në bazë të përgjegjësisë kushtetuese, pra ligjvënëse, mbikëqyrëse dhe përfaqësuese, vetëm pas konstituimit të plotë dhe formimit të grupeve punuese në Kuvend”, thotë Cakolli për Radion Evropa e Lirë.

Sipas tij, pagat e deputetëve dhe asistentëve të tyre zakonisht i kushtojnë taksapaguesve rreth 300 mijë euro në baza mujore.

“Problemi, në këtë rast, është se të drejtat financiare dhe benefitet që kanë deputetët po aktivizohen menjëherë, por përgjegjësitë edhe puna institucionale që ata kanë janë lënë në pritje, për të mos thënë janë zvarritur në tërësi”, thotë Cakolli.

Ai vlerëson se është e domosdoshme që kjo çështje të rregullohet, duke përcaktuar se deputetët mund të angazhojnë staf mbështetës e të gëzojnë benefitet e tjera vetëm pas konstituimit të Kuvendit.

“Në këtë mënyrë, evitohen rastet kur Kuvendi potencialisht mund të mos konstituohet me muaj të tërë, e jo vetëm që deputetët do të merrnin pagat e tyre, por do të merrnin paga edhe asistentët, të cilët, për fat të keq, besoj që kanë pasur nivel minimal, për të mos thënë inekzistent, të angazhimit”, përfundon Cakolli./REL

## Artikuj te sugjeruar

KOSOVA 14 Shtator23:56

### [Specialja interesohet për pasurinë e Thaçit, Veselit, Krasniqit dhe Selimit](#)

Zyrtarë të Dhomave të Specializuara të Kosovës po interesohen për pasurinë e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasn...

KOSOVA 14 Shtator23:30

### [VV-ja shpreh keqardhje për tërheqjen e Sejdiut nga kandidatura](#)

Lëvizja Vetëvendosje ka shprehur keqardhje për tërheqjen e Bekim Sejdiut nga kandidatura për President të Kosovës. Në n...

KOSOVA 14 Shtator21:40

### [“Është bërë djallëzi”/ Goxhaj tregon marrëveshjen që iu vu para Thaçit: Hashimi nuk pa fare çfarë firmosi](#)

Kur na ndajnë edhe dy ditë nga verdikti i Hagës për ish-krerët e UÇK-së, koloneli Dilaver Goxhaj ka sjellë në v&e...

KOSOVA 14 Shtator21:21

### [Koloneli: Gjykata Speciale është bërë që Kosova t’i kthehet Serbisë](#)

Koloneli Dilaver Goxhaj deklaroi se Gjykata Speciale “është bërë me këmbënguljen e Serbisë dhe me Parlamentin Evropian,...

KOSOVA 14 Shtator21:00

### [Abdixhiku pas tërheqjes së Sejdiut: Tregoi dinjitet, sa shumë kemi nevojë për njerëz të mirë](#)

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka reaguar pas tërheqjes së Bekim Sejdiut nga kandidatura për preside...

KOSOVA 14 Shtator20:46

### [“Sa shumë drama politike”/ Bekim Sejdiu flet pas tërheqjes së kandidaturës për President: Po venitet shpresa e qytetarëve](#)

Emri që u propozua para disa javësh si kandidat konsensual për president, ka vendosur të heq dorë. Bekim Sejdiu ka njoftuar se ka vendo...

KOSOVA 14 Shtator19:45

### [16 shtatori në Kosovë/ Ambasada amerikane paralajmëron protestë, udhëzim për punonjësit dhe shtetasit amerikan](#)

Ambasada amerikane në Kosovë ka paralajmëruar ditën e mërkurë më 16 shtator protesta të mëdha q priten të zhvi...

KOSOVA 14 Shtator19:11

### [Bekim Sejdiu tërhiqet nga kandidatura për President të Kosovës](#)

Bekim Sejdiu ka njoftuar se është tërhequr nga kandidatura për president të Republikës së Kosovës, duke thënë ...

KOSOVA 14 Shtator18:08

### [Verdikti për ish-krerët e UÇK-së, Kosova në gatishmëri! Policia paralajmëron kufizime të përkohshme në qarkullim më 16 shtator](#)

Policia e Kosovës ka shtuar masat e sigurisë në prag të 16 shtatorit, ditë kur pritet të shpallet në Hagë aktgjykimi p&e...

KOSOVA 14 Shtator17:28

### [Avokatja e Thaçit: Kundërshtojmë të gjitha transkriptet, fajësia nuk mund të mbështetet në to](#)

Avokatja Sophie Menegon, e cila përfaqëson Hashim Thaçin në çështjen për administrimin e drejtësisë në Gjy...

## ME TE VIZITUARAT

POLITIKE 14 Shtator

### [FOTO- 'Mos u kthe më në Shqipëri'/ Edi Rama sul...](#)

Edi Rama ka sulmuar me thonj dhe ka kërcënuar një emigrant shqiptar në Napoli duke iu drejtuar me fjalët: Të zhduk. Gazetari &C...

AKTUALITET 14 Shtator

### [EMRAT/ Fermë droge prej 4.5 milionë paund në kl...](#)

Një shtetas shqiptar është dënuar me burg për rolin e tij si kultivues në një fermë kanabisi me vlerë 4.5 milion&eu...

POLITIKE 14 Shtator

### ["Rama u tmerrua në sarajet e Surrelit" – Berish...](#)

Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, ka zhvilluar një konferencë për mediat pas rikthimit nga vizita e tij në Shtetet e Bashkuar...

INVESTIGIME 31 Maj14:01


### [Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...


## video



Çdo të premte | ? 20:45 | Syri TV



Çdo të premte | ? 20:45 | Syri TV





**Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave**



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.